

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji "Për metrologjinë"
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FAZAE POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	<ul style="list-style-type: none"> • Direktiva e BE 80/181 EEC për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me njësitë e matjes. • Direktiva 2009/3 EC që amendon Direktiven 80/181 EEC. • Direktiva 2009/34 EC lidhur me dispozitat e përbashkëta për instrumentet matës dhe metodat e kontrollit metrologjik. • Direktiva 2007/45 EC që vendos rregullat për sasi të nominale të produkteve të para-paketuara. • Direktiva e BE 75/107 EEC për përafrimin e legjislacionit të shteteve anëtare lidhur me shishet që përdoren si enë-matëse. • Direktiva e BE, 2014/31 EC për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me përgatitjen dhe hedhjen në treg të instrumenteve jo-automatike të peshimit. • Direktiva e BE 2014/32 EC për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me përgatitjen dhe vendosjen në treg të instrumenteve matës.
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	<p>1. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjen e Tregut 2014-2020 miratuar me VKM nr. 753 datë 16.09.2015 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjen e Tregut".</p> <p>2. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2018-2020.</p>
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	24.11.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	PO, 25.11.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019-MFE-23
TE DHËNA KONTAKTI	

**(EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT
TËPERSONIT TË KONTAKTIT)**

1. Hava Delibashi: 0684381875
hava.delibashi@financa.gov.al
2. Erinda Piluri: 0682094358
erinda.piluri@dpm.gov.al
3. Oriela Shishi: 0673843478
oriela.shishi@dpm.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJEEKZEKUTIVE

(Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Ligji ekzistues nr. 9875 datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i ndryshuar, është ligji bazë që rregullon aktivitetin e metrologjisë lidhur me përdorimin e njësive të matjes, sistemin kombëtar tëetaloneve të matjes, kontrollin metrologjik të instrumenteve matës dhe të produkteve tëparapaketuaradhe shisheve enë-matëse. Ky ligj ka përafuar pjesërisht direktivat e BE për metrologjinë që kanëqënë në fuqi deri në vitin 2008, dhe që janë rishikuar tërësisht gjatë periudhës 2009-2014. Bazuar në këtë ligj, këto aktivitete kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, ndërsa për instrumentet matës kryhen nga Inspektoriati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut bazuar në Ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, si dhe te akteve nënligjore mbështetur në Ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 ‘‘Për Metrologjinë dhe Ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve industriale dhe jo-ushqimore”. Në praktikë janë konstatuar problematika në bashkërendimin e aktiviteteve me inspektoriatin përgjegjës, si psh:

1.Gjatë viteve të fundit, ligji ekzistues nuk i është përgjigjur në nivelin e duhur nevojave për përdorimin e procedurave të unifikuara për kontrollin metrologjik të instrumenteve matës që janë ose nuk janë objekt i markimit CE.

2.Terminologjia teknike dhe shpjegimet përkatëse të përdorura në ligjin ekzistues nuk janë të harmonizuara me terminologjinë ndërkombëtare gjë që sjell keqkuptime dhe keqinterpretime të proceseve dhe procedurave teknike që aplikohen.

3.Rreth 40% e legjislacionit të BE (Direktiva dhe Rregullore) ka të bëjë me matjet dhe përcaktonkërkesat thelbësore për instrumentet matës, metodat e matjes ose materialeve referencë në pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë (ushqim, shëndetësi, mjedis, siguri, mbrojtje e konsumatorit, etj). Legjislacioni për metrologjinë si një nga kollonat e Infrastrukturs së Cilësisë, në themel të Lëvizjes së Lirë të Mallrave, duhet t’i paraprijë dhe t’u përgjigjet akteve ligjore sektoriale kur bëhet fjalë për saktësi të matjeve dhe gjurmueshmëri të tyre tek institucioni përgjegjës për metrologjinë (Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë).

Ndërhyrja që Qeveria synon të ndërmarrë ndërlidhet me disa nga objektivat specifike të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut 2016 – 2020, ku përcaktohen qartë prioritetet e Qeverisë, përkatësisht në objektivin e saj specifik (SP1).

SP1: Përmirësimi i legjislacionit në fushën e metrologjisë në përputhje me direktivat europiane dhe standardet e harmonizuara.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore që synohen të arrihennëpërmjet kësaj politike janë:

-Të unifikohen kërkesat dhe procedurate vlerësimit të konformitetit gjatë kontrollit metrologjik të instrumenteve/pajisjeve matëse objekt i kontrollit metrologjik, me qëllim mbrojtjen e

konsumatorit, shëndetit publik, mjedisit, sigurisë teknike dhe shmangien e barrierave teknike në tregti;

-Të mirëmbahet dhe zgjerohet infrastruktura e nevojshme laboratorike, për të siguruar gjurmueshmërinë e matjeve që nevojiten nga industria dhe ekonomia e vendit, konform kërkesave të organizmave europiane dhe ndërkombëtarë të fushës;

-Të realizohet lëvizja e lirë e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar të cilët janë objekt i markimit CE dhe markimin metrologjik suplementar.

-Të vlerësohen dhe monitorohen produktete parapaketuara, mbi shenjën e konformitetit duke siguruar produkte konformprocedurave.

-Të ruhen dhe mirëmbahen etalonet kombëtare sipas procedurave specifike të matjes (në kushte mjedisore të monitoruara) për të siguruar matje uniforme në Republikën e Shqipërisë.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (status quo): të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues.

Opsioni 1: Shfuqizimi i ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i ndryshuar dhe hartimi i një ligji të ri.

Opsioni 2: Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i ndryshuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar:

Asnjë nga opsionet e marra në shqyrtim nuk ka ndikim me vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin e shtetit.

Nga pikëpamja financiare parashikohet që të ardhurat e grumbulluara në buxhetin e shtetit do të jenë 1.3mln lekë/vit, nga shërbimet e kalibrimit, miratimit të tipit, verifikimit fillestar dhe periodik të instrumenteve dhe pajisjeve matëse. Llogaritja e kësaj vlere është bazuar në të ardhurat e grumbulluara në buxhetin e shtetit gjatë viteve 2017 dhe 2018.

Referuar databazës që ka Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, gjatë vitit 2018 përfitues të shërbimeve janë 75 subjekte importuese dhe 830 përdorues të instrumenteve matës. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka ofruar shërbimin e verifikimit për 24480 klientë, përdorues të instrumenteve matës dhe 410 klientë për kalibrime të instrumenteve matës. Gjithashtu janë regjistruar pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë 100 subjekte të produkteve të parapaketuara dhe iu është ofruar shërbim 10 subjekteve për autorizim të shërbimeve të ndryshme (verifikim, riparim dhe ekspertizë).

Ndikim të drejtpërdrejtë do të ketë edhe tek konsumatori, të cilit do t'i ofrohen matje të sakta dhe të besueshme për produktet dhe shërbimet që merr bazuar në matje. Industrisë do t'i ofrohen matje të gjurmueshme për proceset e veta teknologjike, nëpërputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare për gjurmueshmërinë e matjeve.

Ndikimi mjedisor: Ligji i propozuar ndërmjet të tjerash ka për objekt mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet sigurimit të matjeve të gjurmueshme dhe përdorimit të instrumenteve matëse që plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike të përcaktuara. Ky ligj zbatohet për institucionet shtetërore publike dhe subjektet private të cilat disponojnë dhe përdorin instrumente/pajisje matëse në sektorin e mjedisit. Instrumentet matëse që përdoren nga laboratorët e referencës ose testues duhet të jenë të gjurmueshëm në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga legjislacioni përkatës.

Të gjitha instrumentet matëse me shenjë CE do të hidhen lirisht në tregkundrajt plotësimi të gjithë kërkesave për vlerësimin e tyre të konformitetit duke mos pasur asnjë kosto shërbimi nga institucionet vendase.

Si rrjedhojë e bashkërendimit të punës me strukturën përgjegjëse për inspektimin dhe mbikqyrjen e tregut të instrumenteve matëse do të zgjerohet dhe rritet inspektimi i të gjithë instrumenteve matëse që janë në përdorim.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është *Opsioni 1*: Shfuqizimi i ligjit aktual dhe hartimi i një ligji të ri, për arsye se ndryshimet përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ligjit. Projektligji i ri transponon disa prej dispozitave të direktivave sektoriale të BE për metrologjinë, si dhe është bazuar në Dokumentin D1 të Organizatës Botërore të Metrologjisë Ligjore (OIML), për strukturën e një ligji për metrologjinë. Shqipëria është anëtare me të drejta të plota në këtë organizatë që prej vitit 2001.

Hartimi i një projektligji të ri, do të mundësonte përdorimin e termave dhe përkufizimeve të harmonizuara me të gjithë legjislacionin për produktet industriale dhe jo-ushqimore si dhe standardet e harmonizuara EN të adoptuara në standarde shqiptare; do të qartësonte rregullat që duhet të plotësojnë laboratorët mbajtës të etaloneve kombëtare të matjeve të nevojshëm për të siguruar matje të gjurmueshme në vend do të bënte të mundur unifikimin e procedurave të kontrollit metrologjik të instrumenteve matëse (ekzaminim dhe miratim tipi, verifikim fillestar dhe periodik) për të gjithë kategoritë e instrumenteve matëse me apo pa CE, për të shmangur barrierat teknike në tregti.

Propozimi nuk parashikon ndonjë efekt në buxhetin e shtetit. Gjithashtu nuk parashikohen kosto administrative për zbatimin e tij, ndaj si rezultat nuk pritet të ketë efekte në buxhet.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total leke, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
140 300 000	140 300 000	140 300 000

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?).

Ky sesion do të plotësohet kur paketa ligjore të hidhet për konsultim.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për kordinimin dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit, pas miratimit të këtij propozimi, nëpërmjet strukturave përgjegjëse zbatuese që janë Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes të Tregut.

Për zbatimin e opsionit të preferuar parashikohen gjithashtu një sërë aktesh nënligjore:

- VKM “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”;
- Udhëzim Ministri “Për miratim ose refuzim të sistemit të kontrollit sasior të parapaketimeve”;
- VKM “Për Miratimin e rregullorespër Etalonet Kombëtare të Matjes”;
- VKM “Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI”;
- VKM “Për miratimin e rregullores për Shishet Enë -Matëse”;
- VKM “Përmiratimin e rregullorespërParapaketimet”.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Metrologjia (shkenca e matjeve) është pjesë integrale e infrastruktures së cilësisë së një shteti, dhe si e tillë aktiviteti dhe impakti i aktiviteteve metrologjike të institucionit përgjegjës është i ndjeshëm në të gjithë sektorët e ekonomisë së një shteti.

Kontrolli ligjor i instrumenteve matës në Shqipëri ka origjinën e dokumentuar që në shekullin e XVII, me aktivitet kryesor kontrollin e instrumenteve matës që përdorshin në tregti. Metrologjia moderne u vendos me Ligjin Bashkiak (1921), Ligjin mbi Sistemin Metrik (1922), si dhe Ligjin mbi Masat dhe Sistemin Matës të vitit 1928.

Megjithëse këto ligje ishin moderne për kohën, mungesa e organizimit dhe infrastrukturës së përshtatshme nuk mundësoi zbatimin praktik të tyre. Zgjidhja e këtij problemi u mundësua në vitin 1946 me themelimin e Drejtorisë të Kontrollit të Instrumenteve Matëse. Kështu u mundësua krijimi për herë të parë i një strukture përgjegjëse për Peshat dhe Masat, por infrastruktura laboratorike për kryerjen e verifikimit të instrumenteve matës, të përdorur në prodhim apo tregti, ishte e pamjaftueshme.

Ndërkohë sigurimi i gjurmueshmërisë së matjeve deri në nivelin më të lartë ndërkombëtar mbeti problem për një periudhë relativisht të gjatë. Në periudhën e komunizmit, ashtu si pothuajse në të gjithë vendet e Europës Lindore, metrologjia nënkuptonte vetëm sferën e detyruar, pra metrologjinë ligjore. Pjesërisht gjurmueshmëria e matjeve sigurohej në mënyrë të pavarur nga ish-ndërmarrjet industriale që gjithësesi ishin pronë shtetërore. Mungesa e infrastrukturës, informacionit dhe komunikimit me strukturat rajonale dhe më gjërë të metrologjisë në ato vite ishin faktorët kryesorë që penguan zhvillimin e metrologjisë.

Këto probleme parësore u zgjidhën pjesërisht me themelimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (sot DPM), në vitin 2003 me Ligjin nr. 8996, datë 30.01.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”. Që prej këtij viti kanë ndodhur një sërë ndryshimesh dinamike që janë reflektuar në dispozitat ligjore dhe infrastrukturën zbatuese.

Sot, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është përgjegjëse për metrologjinë shkencore, industriale dhe metrologjinë ligjore, operon në varësi të Ministrisë të Financave dhe

Ekonomisë dhe zhvillon aktivitetin e saj në mbështetje të ligjit Nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, si dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është anëtare e asociuar në Konferencën e Përgjithshme të Peshave dhe Masave prej vitit 2007. Gjithashtu është anëtare e asociuar prej vitit 2009 në Shoqatën e Bashkëpunimit Europian në Metrologjinë Ligjore (WELMEC), si dhe anëtare me të drejta të plota në Shoqatën Europiane të Instituteve Kombëtare të Metrologjisë (EURAMET) prej vitit 2010.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave*

Ligji ekzistues për metrologjinë është miratuar në vitin 2008 dhe gjatë periudhës 10 vjeçare të zbatimit të tij është konstatuar nevoja e rishikimit, për arsye të vijim:

- Ligji ekzistues që gjatë procesit të hartimit të tij (me asistencë të BE, projekti CARDS 2003) ka transpozuar pjesërisht dispozitat e Direktivave të BE-së të cilat janë abroguar ose rishikuar ndërvite;
- Gjatë zbatimit praktik janë konstatuar mangësi, lidhur me disa nga procedurat teknike që aplikohen për qarkullim dhe lëvizjen e instrumenteve/pajisjeve matëse dhe produkteve të parapaketuara, duke shtuar kosto të panevojshme për subjekte që importojnë, tregtojnë apo kanë në përdorim instrumentet e sipërpërmendur.
- Riorganizimi dhe ristrukturimi i inspektoriatit për metrologjinë dhe strukturës për mbikqyrjen e tregut ka nxjerrë në pah nevojën për ristrukturimin dhe mirëkordinimin e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto aktivitete.
- Nevoja për të unifikuar termat dhe përkufizimet e përdorura në përputhje me Fjalorin Ndërkombëtar të Metrologjisë (VIM), termat dhe definicionet e Direktivave të BE-së dhe të udhëzuesve të nxjerrë nga strukturat e Komisionit Europian me qëllim shmangien e problematikave që mund të ndeshen gjatë zbatimit praktik;
- Rekomandimet e dhëna nga ekspertë të strukturave europiane të metrologjisë që kanë asistuar DPM-në gjatë këtyre viteve.

Grupet e prekura nga problemet e sipërlistuar janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Inspektoriatit Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut;
- Institucionet shtetërore dhe publike që merren me matje;
- Bizneset që tregtojnë dhe përdorin instrumente matës objekt i kontrollit metrologjikligjor, laboratorët testues dhe kalibrues që operojnë në sektorët e mjedisit, shëndetit, ushqimit, energjisë, etj;
- Prodhuesit dhe paketuesit e produkteve të para-paketuara dhe shisheve enë-matëse;
- Konsumatorët

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Qeveriaplanifikontëndërhyjë me qëllimkrijimin e një kuadri ligjor, i cili do jetëi përafuar me direktivat europianepërkatësisht:

1. Direktiva 2009/3/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit të Europës e datës 11 mars 2009, “Për njësitë e matjes”;
2. Direktiva 2007/45/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit të Europës, e 5 shtatorit 2007, “Për vendosjen e rregullave për sasitë nominale të produkteve të parapaketuar”;
3. Direktiva 75/107/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit të Europës, e 20 Janarit 1976, “Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me shishet si enëmatëse”;
4. Direktiva 2014/32/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit të Europës e 26 Shkurtit 2014, Harmonizimi i ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me vendosjen në treg të instrumenteve matës (MID).

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje do të mundësohet një bashkërendim i aktiviteteve nga strukturat përgjegjëse përkatësisht, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes të Tregut, si dhe krijohet mundësia e përfshirjes së sektorit privat në sistemin e metrologjisë, nëpërmjet plotësimit të kriterëve ligjore dhe teknike për të kryer verifikimin e instrumenteve matës në fushat ku Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nuk disponon kapacitete.

Gjithashtu, nëpërmjetkësajndërhyrjesynohettëqartësohen, detyrimet e DPM në lidhje me dhënien e informacionit për bizneset mbi rregullat e vendosjes në treg për instrumentet matës dhe produktet e parapaketuara, në përputhje me direktivat e sipërcituara dhe Kapitullin 1 – Lëvizja e Lirë e Mallrave, për transpozimin e *acquis communautaire*.

Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut 2016 – 2020 ështëdokument politik, i cili vendos në qendër të tij konsumatorët dhe synon fuqizimin e tyre për një rol aktiv në treg, duke ushtruar të drejtat dhe fuqinë e tyre të zgjedhjes së mireinformuar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Ndërhyrja që Qeveria synon të ndërmarrë ndërlidhet me disa nga objektivat specifike të përcaktuara nëStrategjinëNdërsektorialepër Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut 2016 – 2020, përcakton qartë prioritetet e Qeverisë, përkatësisht në objektivin e saj specifik (SP1).

SP1: Përmirësimi i legjislacionit në fushën e metrologjisë në përputhje me direktivat europiane dhe standardet e harmonizuara.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Kjo politikë e propozuar synon të arrijë objektivat e mëposhtme:

-Të unifikohen kërkesat dhe proceduratevlerësimit të konformitetit gjatë kontrollit metrologjik të instrumenteve/pajisjeve matëse objekt i kontrollit metrologjik, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit, shëndetit publik, mjedisit, sigurisë teknike dhe shmangien e barrierave teknike në tregti;

-Të mirëmbahet dhe zgjerohet infrastruktura e nevojshme laboratorike për të siguruar gjurmueshmërinë e matjeve që nevojiten nga industria dhe ekonomia e vendit, konform kërkesave të organizmave europiane dhe ndërkombëtare të fushës;

- Të realizohet lëvizja e lirë e instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar të cilët janë objekt i markimit CE dhe markimit metrologjik suplementar.
- Të vlerësohen dhe monitorohen produktet e parapaktuara, mbi shenjën e konformitetit duke siguruar produkte konform procedurave.
- Të ruhen dhe mirëmbahen etalonet kombëtare sipas procedurave specifike të matjes (në kushte mjedisore të monitoruara), për të siguruar matje uniforme në Republikën e Shqipërisë.

Objektivat e sipërm janë të matshëm nëpërmjet numrit të subjekteve që tregtojnë instrumente matëse objekt i kontrollit metrologjik ligjor (rritje me 2% krahasuar me vitin paraardhës), numrit dhe kategorive të instrumenteve matëse me shenjën CE (rritje me 2% krahasuar me vitin paraardhës), numrit të laboratorëve të etaloneve të matjeve dhe numrit të kalibrimeve që janë të gjurmueshëm në përputhje me rregullat ndërkombëtare (rritje me 2% të numrit të kalibrimeve dhe mirëmbajtje të etaloneve të matjeve në 12 fusha matjeje).

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës që është kryer, janë shqyrtuar tre opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0 (status quo):

Ligjiekzistuesnr.9875, datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë” ka transpozuar pjesërisht dispozita të Direktivave të BE për metrologjinë të cilat janë abroguar ose rishikuar ndërvite (2009-2014). Mbajtja në fuqi e ligjit ekzistues krijon konfuzion dhe paqartësi duke filluar që me terminologjinë e përdorur, ka mangësi në përcaktimin e rregullave dhe procedurave që zbatohen gjatë kontrollit metrologjik të instrumenteve matëse.

Opsioni 1 Hartimi i një ligji të ri për metrologjinë:

Hartimi i një projektligji të ri do të bënte të mundur përcaktimin e rregullave të qarta për njësitë ligjore të matjes që lejohen të përdoren në territorin e Republikës të Shqipërisë, do të bënte të mundur vendosjen e rregullave dhe procedurave të qarta për laboratorët e etaloneve kombëtare të matjeve, të unifikojë përdorimin e të njëjtave procedura teknike të vlerësimit të konformitetit për të gjithë kategoritë e instrumenteve matës objekt i kontrollit metrologjik (me apo pa shenjën CE). Problemet që zgjidhen me projektligjin e ri prekin rreth 50% të përmbajtjes së ligjit ekzistues.

Opsioni 2 Ndryshimi i ligjit ekzistues:

Problematikat e hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, nuk mund të zgjidhen me ndryshime në ligjin ekzistues, për shkak të ndërhyrjeve të konsiderueshme në përmbajtje të ligjit, që janë mbi 50% të tij.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*

- Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
 - Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
 - Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Ndikimet ekonomike:

Ndikimi është i drejtpërdrejtë, kryesisht tek subjektet e prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të instrumenteve matesepasi lejohet vetëm tregtimi dhe përdorimi i instrumenteve matës që i plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike të përcaktuara. Përfitimi ekonomik që pritet të vijë si rezultat i kësaj politike do të jetë që operatorët ekonomikë do të shmangin kostot për verifikim fillestar dhe miratim tipi në kuadertë hedhjes në treg të instrumenteve matës me shenjë CE. Gjithashtu biznesi do të përfitojë nga qartësimi dhe harmonizimi i detyrave të përcaktuara.

Të gjitha instrumentet matës me shenjë CE do të hidhen lirisht në treg kundrejt plotësimit të gjithë kërkesave për vlerësimin e tyre të konformitetit, duke mos pasur asnjë kosto shërbimi nga institucionet vendase.

Ndikim të drejtpërdrejtë do të ketë edhe tek konsumatori, të cilit do t'i ofrohen matje të sakta dhe të besueshme për produktet dhe shërbimet që merr bazuar në matje.

Industrië do t'i ofrohen matje të gjurmueshme për proceset e veta teknologjike, në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare për gjurmueshmërinë e matjeve.

Ndikimi mjedisor:

Ligji i propozuar ndërmjet të tjerash ka për objekt mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet sigurimit të matjeve të gjurmueshme dhe përdorimit të instrumenteve matës që plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike të përcaktuara. Ky ligj zbatohet për institucionet shtetërore publike, dhe subjektet private të cilat disponojnë dhe përdorin instrumente/pajisje matëse në sektorin e mjedisit. Instrumentet matëse që përdoren nga laboratorët e referencës ose testues duhet të jenë të gjurmueshëm në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga legjislativi përkatës.

Si rrjedhojë e bashkëndimit të punës me strukturën përgjegjëse për inspektimin dhe mbikqyrjen e tregut të instrumenteve matëse do të zgjerohet dhe rritet inspektimi i të gjithë instrumenteve matëse që janë në përdorim.

Ndikimi social:

Përdoruesit e instrumenteve matës dhe prodhuesit apo importuesit e produkteve tëparapaketuarado të përfitojnë shërbime metrologjike me standarde bashkohore, ku si rezultat do të shërbehet me cilësi që do të kenë ndikim edhe në ruajtjen/jetëgjatësinë e instrumentevematës gjatë përdorimit. (ndikimet jo të drejtpërdrejta).Gjithashtu opsioni i preferuar përmirëson sigurinë dhe shëndetin e konsumatorëve nëpërmjet reduktimit të numrit të produktevejokonforme që gjenden në treg, mbron njëkohësisht shitësin dhe blerësin në një transaksion tregtar.

Propozimi pritet gjithashtu të sjellë funksionim më të mirë të institucionit, nëpërmjet rregullimit të kuadrit ligjor, pa kosto shtesë, duke shfrytëzuar kapacitetet dhe eksperiencën aktuale të fituar në vite në këtë institucion, si dhe plotësimin e kërkesave të legjislacionit sektorial – kapitulli 1 – Lëvizja e Lirë e Mallrave.

Përmbledhje e ndikimeve

- Përmbledhja e ndikimeve jepet nëtabelën më poshtë.

Ndikimet		Grupet e prekura		Përshkrimi i ndikimit
Ndikimet ekonomike	Të drejtpërdrejta	Kostot	Sektori publik (buxheti i shtetit)	Nuk ka kosto direkte.
			Bizneset	Eliminimi i tarifave për miratim tipi dhe verifikim fillestar për instrumente matës me shenjë CE.
		Përfitimet	Individët	Cilësi më e mirë e shërbimeve
	Bizneset		Eliminohet barriera administrative	
	Sektori publik, shoqëria dhe ekonomia e gjerë		Siguron kushte që sektori privat të ofrojë shërbime me cilësore për përdoruesit e instrumenteve matës	
	Jo të drejtpërdrejta	Përfitimet	Ekonomia e gjerë	Përdorimi i instrumenteve matës me saktësi të lartë, rrit cilësinë e mbrojtjes të konsumatorit nga matjet e pasakta.
Ndikimet sociale	Të drejtpërdrejta	Përfitimet	Shoqëria dhe ekonomia e gjerë	Përdoruesit e instrumenteve matës do të përfitojnë shërbim me standardebashkohore (gjatë kryerjes së shërbimevetmetrologjike), por si rezultat do të shërbehen me cilësi që do të ketë ndikim edhe në ruajtjen/jetëgjatësinë e instrumenteve matës(ndikimet jo të drejtpërdrejta).
		Përfitimet	Individët (përdoruesit e	Secili nga përdoruesit instrumenteve matës do të mund të përfitojë nga lëvizja e lirë e

	Jo të drejtpërdrejta		instrumenteve matës)	instrumenteve matës me shenje CE.
			Shoqëria	Do të ofrohen shërbime më të mira metrologjike për gjithë shoqërinë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është **Opsioni 1**-Shfuqizimi i ligjit aktual dhe hartimi i një ligji të ri, për arsye se ndryshimet përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ligjit. Projektligji i ri transponon disa prej dispozitave të direktivave sektoriale të BE-së për metrologjinë si dhe është bazuar në Dokumentin D1 të Organizatës Botërore të Metrologjisë Ligjore (OIML), për strukturën e një ligji për metrologjinë. Shqipëria aderon në këtë organizatë që prej vitit 2001. Projektligji i ri mundëson përdorimin e termave dhe përkufizimeve të harmonizuara me të gjithë legjislacionin për produktet industriale dhe jo-ushqimore si dhe standardet e harmonizuara EN të adoptuara në standarde shqiptare; qartëson rregullat që duhet të plotësojnë laboratorët mbajtës të etaloneve kombëtare të matjeve të nevojshme për të siguruar matje të gjurmueshme në vend; unifikon procedurat e kontrollit metrologjik të instrumenteve matëse (ekzaminim dhe miratim tipi, verifikim fillestar dhe periodik) për të gjithë kategoritë e instrumenteve matëse me apo pa CE, për të shmangur barrierat teknike në tregti. Ky projektligj krijon mundësinë e përfshirjes së sektorit privat në sistemin e metrologjisë nëpërmjet, plotësimit të kriterëve ligjore dhe teknike për të kryer verifikim të instrumenteve matës në fushat ku Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nuk disponon kapacitete.

Nëpërmjet ligjit të ri mundësohet një bashkërendim i aktiviteteve nga strukturat përgjegjëse përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe inspektorati që mbulon metrologjinë.

Propozimi nuk parashikon ndonjë efekt në buxhetin e shtetit. Gjithashtu nuk parashikohen kosto administrative për zbatimin e tij, ndaj si rezultat nuk pritet të ketë efekte në buxhet.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit, pas miratimit të këtij propozimi, nëpërmjet strukturave përgjegjëse (Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut) për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Përkatësisht:

1.Institucioni/autoriteti shtetëror përgjegjës për metrologjinë, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë:

- disponon laboratorët e etaloneve kombëtarë të matjeve, të cilët përbëjnë majën e piramidës së infrastrukturës së matjeve dhe shërbejnësi laboratorë referencë për të siguruar gjurmueshmërinë e matjeve të kryera në vend deri te njësitë e Sistemit Ndërkombëtar SI;
- kryen miratimin e tipit dhe verifikimin fillestar dhe periodik të instrumenteve matës kundrejt procedurave teknike të harmonizuara me ato të BE;

-miraton sistemin e kontrollit të sasisë neto të produkteve tëparapaketuara, etj;

2. Personat juridikë që autorizohen kundrejt kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga ligji, për të kryer verifikim periodik të instrumenteve në metrologjinë ligjore (për fushat ku Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nuk disponon kapacitete), sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Personat juridikë dhe fizikë që autorizohen kundrejt kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga ligji për të kryer riparim të instrumentëve matës kur ato janë në përdorim.

4. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut që mbulon fushën e metrologjisë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të instrumenteve matëse me shenjen CE, për inspektimin e instrumenteve matës në përdorim dhe për kontrollin sasior të produkteve tëparapaketuara të vendosura në treg. Inspektimi metrologjik kryhet nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit shoqërues të instrumenteve matëse, si dhe kryerjes së matjeve (me laboratorë televizshëm që ka në dispozicion) kur gjykohet e nevojshme bazuar në metodologjinë e riskut. Inspektoriati bashkëpunon ngushtësisht me strukturat doganore lidhur me instrumentet matës që importohen nga jashtë.

Për zbatimin e ligjit dhe përputhshmërinë me kërkesat e tij do të ndërmerren hapat e mëposhtme:

- o Do të hartohen/rishikohen aktet nënligjore që rrjedhin prej këtij ligji;
- o Do të kryhet informimi i prodhuesve, importuesve dhe përdoruesve të instrumenteve matëse, për kërkesat dhe rregullat e kontrollit metrologjik të instrumenteve matëse që hyjnë dhe përdoren në territorin e Republikës të Shqipërisë.

Aktet nënligjore që do të dalin/rishikohen në zbatim të këtij ligji janë:

-VKM “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”;

-Udhëzim Ministri “Për miratim ose refuzim të sistemit të kontrollit sasior të parapaketimeve”;

- VKM “Për miratimin e rregullores për Etalonet Kombëtare të Matjes”;

- VKM “Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI”;

-VKM “Për miratimin e rregullores për Shishet Enë Matëse”;

- VKM “Për miratimin e rregullores për Parapaketimet”.

Për zbatimin e opsionit të preferuar nuk parashikohet të ketë pengesa të mundshme.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Opsioni i preferuar përmban elementë të rëndësishëm për zbatimin e planit të punës për sistemin e monitorimit dhe vlerësimit në zbatimin e ligjit, bazuar në problemet e konstatuara, për përcaktimin e organeve përgjegjëse për respektimin dhe garantimin e të gjithave shërbimeve të nevojshme, për bashkërendimin e punës dhe dhënien e mbështetjes për standardet teknike dhe mënyrat e analizave që kryhen.

Zbatimi i opsionit të preferuar dhe arritja e objektivave të tij do të monitorohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë. Institucionet përkatëse zbatuese, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Inspektoriati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut do të bëjnë të mundur

zbatimin e masave, nëpërmjet planeve konkrete të punës dhe do të raportojnë periodikisht tek ministria përgjegjëse.

Indikatorët për të matur arritjen e objektivave do të rishikohen dhe përcaktohen çdo vit kalendarik, si vijon:

- a) Sasia dhe llojshmëria e instrumenteve matëse që i nënshtrohen kontrollit metrologjik çdo vit, bazuar në procedurat e përshkruara; (instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim të jenë të verifikuara dhe të mirëmbajtura sipas akteve ligjore në fuqi);
- b) Numri i fushave të matjes (laboratorëve të etaloneve) të njohura ndërkombëtarisht;
- c) Implementimi i sistemit të menaxhimit të cilësise në të gjithë strukturat zbatuese të ligjit, në përputhje me kërkesat e standardeve ISO 17025, ISO 17020, ISO 17065, ISO 17043;
- d) Rritja e numrit të inspektimeve metrologjike dhe reduktimi i ankesave për matje të pasakta nga kosnumatorët;
- e) Regjistrat e instrumenteve matës objekt i kontrollit metrologjik, të administruar.

Raporti i vlerësimit të ndikimit –Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Opsioni 1

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktorizbritës	1	0.952 835	0.907 894	0.86 573	0.824 271	0.785 394	0.748 351	0.713 055	0.649 423	0.6473 78
Kostopërbuxhetin – njëherë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kostopërbuxhetin – në vazhdim	140,3	140,3	140,3	143,1	146	148,9	151,9	154,9	158	161,2
Kostopërbiznesin – njëherë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kostopërbiznesin – në vazhdim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera – njëherë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kostonë total	1.485,0									
Kosto e zbritur në total = Kostonë total x faktorizbritës	1.318,2									
Përfitimipërbuxhetin – në vazhdim	122,1	121	123	125,5	127,9	130,5	133,1	135,7	138,4	141,2
Përfitimipërbiznesin – njëherë										
Përfitimipërbiznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Përfitimi për buxhetin – njëherë										
Përfitiminë total	1.298,4									

Përfitimiizbriturnë total = Përfitiminë total x faktorinzbritës	1.043, 3									
Vlera aktuale e kostos në total	1.318, 2									
Vlera aktuale e përfitimit në total	1.043, 3									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	- 274,9									

Shënim 1: Tarifat e shërbimit që zbaton DPM janë tarifa me TVSH. Të ardhurat e hedhura në tabelë janë plani pa TVSH, që do të thotë që në buxhet shkojnë në formën e TVSH edhe 20% të ardhura mbi ato që janë në tabelë.

Shënim 2: Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve përtej periudhës 2020-2022 është mbështetur në një rritje mesatare me 2 %.

Opsioni 2

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktorizbritës	1	0.952 835	0.907 894	0.86 573	0.824 271	0.785 394	0.748 351	0.713 055	0.649 423	0.6473 78
Kostopërbuxhetin – njëherë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kostopërbuxhetin – në vazhdim	140,3	140,3	140,3	143, 1	146	148,9	151,9	154,9	158	161,2
Kostopërbiznesin – njëherë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kostopërbiznesin – në vazhdim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera – një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kostonë total	1.485, 0									
Kosto e zbriturnë total = Kostonë total x faktorinzbritës	1.318, 2									
Përfitimipërbuxhetin – në vazhdim	122,1	121	123	125, 5	127,9	130,5	133,1	135,7	138,4	141,2
Përfitimipërbiznesin – njëherë										
Përfitimipërbiznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Përfitimi për buxhetin – një herë										
Përfitiminë total	1.298, 4									
Përfitimiazbriturnë total = Përfitiminë total x faktorinzbritës	1.043, 3									

Vlera aktuale e kostos në total	1.318,2
Vlera aktuale e përfitimit në total	1.043,3
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	-274,9

Shënim 1: Tarifat e shërbimit që zbaton DPM janë tarifa me TVSH. Të ardhurat e hedhura në tabelë janë plani pa TVSH, që do të thotë që në buxhet shkojnë në formën e TVSH edhe 20% të ardhura mbi ato që janë në tabelë.

Shënim 2: Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve përtej periudhës 2020-2022 është mbështetur në një rritje mesatare me 2 %.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	1.318,2	1.043,3	-274,9
Opsioni 2	1.318,2	1.043,3	-274,9

Opsioni i preferuar është opsioni i parë pasi edhe pse ka të njëjtin VAN me opsionin e dytë, për arsye të teknikës legjislativeduke qënë që ndryshimet do të preknin në një masë të madhe disa ligje ekzistuese, qeveria do të ndërhyje me një projektligj të ri.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë
Anila Denaj